

Wetswil-Bonsteten : FC Kosova Zürich 0 - 1

## Vazhdon seria e fitoreve të shkëlqyeshme të skuadrës shqiptare

FC Kosova: Përparim Bunjaku, Shukri Latifi, Visar Sylaj, Samet Pajaziti, Shpend Latifi, Musli Haxhiu, Ismajl Bunjaku, Arlind Rexhaj, Mikel Lazri, Fidan Alidemaj (72' Sefer Haxhiu) und Adnan Jashari. Rezervë: Milaim Lakna, Valon Latifi, Azdren Avdijaj, Përparim Veliu dhe Mërgim Rushiti. Goli: Minuta e 5-të, Musli Haxhiu 1:0. Shikues: rreth 600.



Musli Haxhiu, autor i golit të fitores

FC "Kosova" e Cyrihut nuk ka të ndalur në vrapin e saj për të siguruar titullin e kampionit në Ligën e Dytë regionale të Cyrihut, kategori kjo në të cilën skuadra jonë është ngjitur jo më parë se në këtë sezon! Djelmohat e Enver Osmanit, ndonëse kanë pasur para vetes një kundërshtar të fortë dhe të papërshtatshëm, atë Wetswil-Bonsteten, ia kanë dalë të importojnë tri pikë shumë të çmuara nga stadiumi ku ishin në cilësinë e mysafirit. Ndryshe nga ndeshja e javës së kaluar, ku kosovarët shënuan katër gola (plus një autogol!), kësaj here ata u mjaftuan me një gol të vetëm por, të mjaftueshëm për të siguruar pikët e fitores. Golin që në fillim të ndeshjes, në minutën e pestë (5) e shënoi Musliu Haxhiu, njëri ndër dy vëllezërit Haxhiu, të njohur si golashënuesit më të frytshëm të skuadrës.

Pas golit të shënuar nga FC Kosova, e gjithë ndeshja është përshkuar nga një tensionim, i nxitur nga skuadra humbëse, në përpjekjet e saj që me çdo kusht të shënojë golin e barazimit. FC Wetswil-Bonsteten, e cila është në pozitën e dytë të tabelës së klasifikimit, pas FC Kosovës, madje pati edhe ndihmën



Tifozët e FC Kosova të Cyrihut

## Në ndeshjen e ardhshme, mysafir edhe Ambasadori i Kosovës, z. Naim Malaj!

Ambasadori i Republikës së Kosovës në Bern z. Naim Malaj ka konfirmuar pjesëmarrjen e tij në ndeshjen e radhës ndërmjet FC Kosovës dhe FC Uster, e vlefshme për kupën e Zvicrës. Ndeshja zhvillohet të mërkurën më 22 prill në ora 20:00 në fushën e futbollit Buchlern, Friedhofstrasse në Zürich. Lusim përkrahësit, dashamirët dhe të gjithë të interesuarit që të vijnë më së voni rreth orës 19:30. Pritet që ambasadori, para fillimit të ndeshjes, të ju drejtohet të pranishmëve me një fjalë rasti. Para, gjatë dhe pas ndeshjes do të ju shërbejmë me pije dhe ushqime të ndryshme. Konsumimi i tyre do të ndihmojë drejtpërdrejt fondin e FC Kosovës.

**Për informacione tjera: Qaushi: 076 428 99 91 dhe Arsimi: 079 353 60 29 (Nga www.fckosova.ch)**

e pakursyer të arbitrit kryesor, i cili për shkaqe që i di vetëm ai, e zgjati ndeshjen për plot 12 minuta! Por as kjo zgjatje dhe as loja, në momente, e ashpër dhe provokuese e sulmuesve të ekipit vendës, nuk ia mori dot nga duart fitoren e vlefshme FC Kosovës. Është kjo fitorja e pestë me radhë e lojtarëve shqiptarë që nga fillimi i sezonit pranveror, ndërsa e dyta kundër ekipeve pretenduese për titull.

Me këtë fitore, skuadra shqiptare e Cyrihut përforcon edhe më tej pretendimet e saj tashmë me shumë se reale për të zënë vendin e parë në ligë dhe për të bërë hapin në ligën e parë regionale të Cyrihut. Për këtë ajo ka pasur dhe do të ketë edhe më shumë, përkrahjen e publikut besnik dhe të flakët shqiptar, i cili di që të krijojë atmosferë shumë impozante në stadiumet ku luajnë djelmohat e skuadrës sonë.

Berlin: FC Liria - SV Blau Gelb 0:2 (0:1)

## Një hap para, dy mbrapa !

FC Liria: Irfan Jerliu(3), Nazim Jahaj(3), Menderes Rexha(4), Bashkim Beqiri(3), Besim Hyseni(3,5) (Leonard Salijaj) Përparim Halimi (2,5), Kasam Dervishi (3), Fabian Përdedaj (3) Basri Dervishi(4) Isuf Pepshi(3) dhe Labinot Restelica (3,5) (Adriatik Çollakaj). Trajner: Arsim Hyseni, nd Xhemajl Elezi.

### Bislim Selmani

Skuadra shqiptare nga kryeqyteti gjerman, në mes javë zhvilloi takimin e mbetur kundër të parit në tabelë, Wartenberger SV duke arritur që nga ky takim i vështirë të kthehet e pa mposhtur me rezultat të barabartë, 3:3, edhe pse ka mundur lehtë të kthehet me gjuhë të plot, sikur lojtarët të ishin pak më shumë të koncentruar. Vlen të ceket sidomos loja brilante e Përparim Halimit, i cili me dy golat e tij, ishte figura qendrore e takimit.

Ndërkaq, takimin tjetër të rregullt, FC "Liria" e zhvilloi në fushën e vet këtë të dielë, kundër rivalit që lufton për mbijetesë sikur edhe skuadra shqiptare. Mirëpo kësaj radhe skuadra jonë ishte në aut sa i përket lojës, me ç'rast ajo nuk arriti të tregojë as për së afërmi nivelin që tregoi kundër Wartenbergut.

Skuadra shqiptare me këtë humb-

je është duke i minimizuar gjasat për mbijetesë kurse trajnerit Hyseni i ka "humbur rruga në oborr" dhe është në hall për ndeshjet në vazhdim kur secili takim i ka epitetin e krye ndeshjes.

Takimi kundër SV Blau Gelb u prit me optimizëm sidomos pas importimit të një pike kundër të parit në tabelë. Ishte ky një hap i madh në një moment të duhur, por pa kaluar një javë, skuadra jonë u kthye dy hapa mbrapa! FC Liria tregoi një lojë tejet anemike dhe aspak kreative, duke lënë përshtypjen se i mungon dirigjenti i lojës dhe golashënuesi i rangut të Gëzim Jahdatit i cili në kampionatin e kaluar pati shënuar mbi 40 gola. Ndërsa në këtë edicion po ndjehet me të madhe nevoja për një golashënues si ai. Skuadrës sonë deri në fund të këtij edicioni i kanë mbetur t'i zhvillojë edhe shtatë takime; katër në fushën e vet e tri si mysafirë. Shikuar real-

isht FC "Liria" ka orar të favorshëm pasi që në fushë të vet i pret dy pretendentët që luftojnë po ashtu për mbijetesë në këtë shoqëri, dhe sipas orarit, skuadrës sonë, për të mbetur në këtë shoqëri garash i duhet që nga këto takimet e mbetura t'i fitojë katër ndeshje, ose së paku tri dhe një barazim. Prandaj stafi i kësaj skuadre nuk duhet të bjerë në gjumin letargjik por duhet punë dhe angazhim permanent nëse e dëshiron mbijetesën.

Skuadra jonë takimin e radhës do ta zhvillojë këtë të diele kundër skuadrës FC "Lübar"s e cila ka vetëm një pikë më pak se skuadra jonë, dhe me të drejtë ky takim ka epitetin e krye ndeshjes së të rrezikuarve, prandaj adhuruesit e skuadrës shqiptare duhet të gjenden pranë saj në ditët më të vështira që po e ndjekin atë, në këto momente ku po e heq të zitë e ullirit për mbijetesë.

Më 25.04 mbahet Kampionati i Diturisë "Berlini 2009"

## Gjithëçka gati për shpalosjen e dijes së nxënësve shqiptarë

Garat e diturisë, të fëmijëve që ndjekin mësimin e gjuhës amtare në Gjermani, i organizon Këshilli i Arsimitarëve Shqiptarë "Naim Frashëri" në Gjermani, kurse mikpritës është Shoqata Arsimore Kulturore dhe Sportive "Shkëndija" në Berlin

Më 25.04.2009, në Kant Gymnasium, Bismarks 54, 13585, Berlin Spandau, me fillim në orën 14,00, organizohet Kampionati i Diturisë, i tetëmbëdhjeti me radhë.

Këto gara të diturisë, të fëmijëve që ndjekin mësimin e gjuhës amtare anekënd Gjermanisë, si çdo herë i organizon Këshilli i Arsimitarëve Shqiptarë "Naim Frashëri" në Gjermani, kurse mikpritës është Shoqata Arsimore Kulturore dhe Sportive "Shkëndija" në Berlin. Kënaqësi e veçantë kësaj radhe është se këto gara për herë të parë mbahen nën patronatin e Ambasadës së Republikës së Kosovës, në Berlin.

Tanimë janë kryer të gjitha përgatitjet teknike nga nikoqiri, dhe ato profesionale nga Këshilli i Arsimitarëve dhe nga Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës, e cila edhe ka angazhuar personin zyrtar, Nuhi Gashin t'i përcjellë këto gara dhe t'i hartojë pyetjet për këto gara, të sajuara në bazë të materialit të përgatitur nga arsimtarët e mësimin plotësues në Gjermani. Lëmenjtë në të cilët do të garojnë nxënësit janë: gjuha, gjeografia gjithëkombëtare, historia e Shtetit të Kosovës, njohja dhe identifikimi i figurave dhe monumenteve historike gjithë-

kombëtare, fjalë të urta popullore, interpretim i një kënge e një poezie si dhe nga jeta në Gjermani.

Është caktuar edhe juria pesëanëtarëshe për vlerësimin e përgjigjeve, kryetar i së cilës është caktuar zyrtari i Ministrisë, zoti Nuhi Gashi, si dhe moderatorja e garave, zonja Adriana. Në gara do të marrin pjesë 12 shkolla, me rreth 120 garues e shumë prindër nga Berlioni dhe e gjithë Gjermania. Mikpritësi, gjithashtu ka siguruar edhe shpërblimet për tri vendet e para, kurse KASH-i do të ndajë diploma për fituesit dhe pjesëmarrësit në gara. Mirënjohje do t'u ndahet edhe arsimtarëve që për një kohë të gjatë kanë punuar në mësimin plotësues në Gjermani, e tani kohë më parë janë pensionuar. Mirënjohje do t'u ndahet edhe Redaksive të Gazetave ditore, "Zëri i ditës" dhe asaj "Bota sot" për kontributin e dhënë në përcjelljen dhe afirmimin e Shkollës Shqipe në Gjermani.

Ju mirëpresin në këtë aktivitet kulturor: Këshilli i Arsimitarëve Shqiptarë "Naim Frashëri" në Gjermani dhe nikoqiri, Shoqata Arsimore Kulturore e Sportive "Shkëndija" në Berlin.

(Për KASH-in:  
Rifat Hamiti-nënkryetar)



Organizuar nga Qendra Kulturore Shqiptare në Cyrih

## Më 26 prill, takimet "Me Agim Ramadanin 2009"

Takimet "Me Agim Ramadanin 2009" mbahen për të dhjetën herë, më 26 prill 2009, nga ora 14.00, në Restaurant Salmen, Uitikonstrasse 17 CH-8952 Schlieren. Me këtë rast do të prezantohet një program i pasur kulturor artistik. Pjesëmarrjen, veç grupeve të ndryshme artistike nga diaspora, e ka konfirmuar edhe aktori ynë i madh Reshat Arbana, i njohur për recitimet e tij të fuqishme të vargjeve nga tradita e jonë epike.

Po ashtu, në këtë manifestim do të bëhet edhe shpallja e rezultateve të konkursit për poezi dhe atij për arte pamore, të shpallur nga QKSH dhe të publikuar edhe në gazetën tonë. Përzgjedhja bëhet nga juritë profesionale.

**Për informata tjera:**

**Tel. 079 542 90 63**

**Tel. 078 767 11 14**

## E pame në familjen Krasniqi

Familja e Ibrahim Krasniqit nga Hinwili i Kantonit të Cyrihut hap të pame për vajzën Mirvete Maliqi-Krasniqi, që ka ndërruar jetë më 09 prill 2009 në Riniken të Kantonit Aargau. E Pamja mbahet prej ditës së shtunë, më 18 prill deri të mërkurën, më 22 prill 2009 nga ora 10.00 e mëngjesit.

Adresa: Alpenblickstrasse 5 8340 Hinwil ZH. Tel.0794201687